



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr500/26
Dt. 15.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe ZPP-së, më dt. 15.06.2026 merrë:

V E N D I M

Emërohet Menaxherë i kontratës përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **"Furnizim me pajisje elektrike për amvisri", me numer të prokurimit: VU644-26-3331-1-3-6 apo nr. i brendshem: VU644-26-019-136** si vijon :

Isuf Gërguri, emërohet menaxher i kontratës.

Naile Kovaçi Bektashi, emërohet mbikëqyrës i drejtpërdrejt imenaxherit të kontratës.

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rrobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të

kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

2. Për Komision të Pranimit të mallit të porositur dhe të furnizuar sipas projektit njësitë kërkuese duhet të formojnë nga një komision ad-hoc.

4. Komisioni, si në nenin 3 të këtij Vendimi, secili për pjesën e tij të përgjegjësisë, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiorë të furnizimeve dhe / ose shërbimeve sipas Kërkesës – Porosisë për blerje të Njesisë Kërkuese të cilën e përfaqëson, si dhe pranimin e mallit të dorëzuar, ku kryes i furnizimeve për materialin sipas përshkrimit **Furnizim me pajisje elektrike për amvisri** është OE : **“INFINIT SH.P.K në bazë të kontratës nr. C/1146me datë: 12.06.2026.**
5. Komisioni do të filloi me punë me të pranuar të këtij Aktvendimi ndërsa do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njesisë Shpenzuese gjegjëse si dhe Menaxherin e Kontratës të Kontraktuesit.
6. Nëse Komisioni konstaton të meta dhe/ ose parregullësi në cilësinë ose përshtatshmërinë e mallit të dorëzuar, atëherë Komisioni do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive dhe / ose mangësive të konstatuara dhe të pranoi mallin pas mënjimit të mangësive të konstatuara.
7. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë do të hartoi **Raport në të cili do të konfirmoi** përfundimin e furnizimeve të Porositura , të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.
8. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – **Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorëve Ekonomik**

Kopje: 1 x 1 Menaxheri i Kontratës;
1 x 1 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;
1 x 1 Komisionit të pranimit të mallit;
1 x 1 Drejtorisë së Prokurimit.

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

644-26-3331-1-3-6/C1146

14 Nr.495/26

Dt. 12.06.2026

KONTRATË

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik-së** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. **" INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, PRISHTINË**, ne anën tjetër, pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

1.2 Furnizim me pajisje elektrike për amvisri

Nr. i Prokurimit ¹	644-26-3331-1-3-6
Nr i brendshëm	VU644-26-19-136

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë është **Drejtoria e Arsimit Vushtrri**

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë **DDP**.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **5,473.00 €**; [pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

[shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.5 Sigurimi i ekzekutimit të kontratës 10% (dhjet përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës.

Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 40 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Astrit Uka
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2026	Data:	12.06.2026
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **150826**

Për **KOMUNA E VUSHTRRIË**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **INFINITT SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me pajisje elektrike për amvisri**

Nr. prokurimit: 644-26-3331-1-3-6 , Nr. brendshëm: VU644-26-19-136

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **547.30€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **547.30€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 40 ditë kalendrike prej **12.06.2026** deri më **22.07.2026**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 11.06.2026

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **150826**

Kontraktuesi	
Emri	INFINITT SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Astrit Uka
Adresa	Prishtinë, Dëshmorët e Kombit
Nr i Biznesit	810860818
Telefoni	044974590
Përfituesi	
Emri	KOMUNA E VUSHTRRIË
Adresa	Vushtrri
Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB
Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	547.30
Periudha Sigurimit	12.06.2026 - 22.07.2026
Primi	20.00
Tvsh	3.60
Primi Bruto	23.60
Data e lëshimit	11.06.2026 10:04
Aktiviteti Ekonomik: Furnizim me pajisje elektrike për amvisri	

Lënda e Garancisë
Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:
1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Premium Broker - 2304



Përfaqësuesi i të siguarit
Astrit Uka



AA9260226703125



REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTERE

ANDUENA I. GASHI SHEHU

RRUGA "JUSUF GËRVALLA" NR.78, PRISHTINË

LRP.nr.964/2026

-----AKT NOTERIAL-----

Sot, me datë 26.02.2026 (njëzet e gjashtë shkurt dy mijë e njëzet e gjashtë) në ora 14:45, para meje Anduena I. Gashi Shehu notere, me seli në Prishtinë, Rr. "Jusuf Gërvalla" nr.78, është paraqitur pala si në vijim:-----

1. Kompania "INFINITT" SH.P.K., me numër unik identifikues 810860818, me adresë në Rr. "Dëshmorët e Kombit", Prishtinë, të cilën e përfaqëson pronarja, Znj. Selvije Krasniqi, e bija Adem-it, e lindur në Prugoc, më datë 16.05.1961 (gjashtëmbëdhjetë maj një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një), shtetase e Republikës së Kosovës, me vendbanim sipas deklarimit të saj në Rr. "Dëshmorët e Kombit", Prishtinë, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal 1010390482, të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, madhore, me zotësi veprimi, (në cilësinë e Autorizimdhënëses).-----

Pasi u konstatua se pala e pranishme ka zotësi të plotë për të vepruar, vepron me vullnet të lirë dhe është në dijeni të pasojave juridike që rrjedhin nga ky akt, si dhe pas dhënies së shpjegimeve juridike nga ana e noteres lidhur me përmbajtjen, efektet dhe pasojat e këtij akti, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Noterinë, pala e pranishme kërkon nga noterja të përpilojë këtë akt noterial.-----

-----AUTORIZIM I PËRGJITHSHËM PËR BIZNES-----

Në cilësinë e pronares së kompanisë autorizojë:-----

2. Z. Albert Kosumi, i lindur në Tugjeç, më datë 28.08.1989 (njëzet e tetë gusht një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë), shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal 1232181261, i lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, madhor, me zotësi veprimi.-----

3. Z. Trim Fazliu, i lindur në Prishtinë, më datë 27.04.2001 (njëzet e shtatë prill dy mijë e një), shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal 1231249628, i lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, madhor, me zotësi veprimi.-----

Që në mënyrë të plotë dhe të pakufizuar të ndërmarrin këto veprime procedurale juridike, financiare dhe administrative, si vijon:-----




AA9260226703125

Ky akt noterial u krye në selinë e noteres Anduena I. Gashi Shehu në adresën e lartshënuar me datë 26.02.2026 (njëzet e gjashtë shkurt dy mijë e njëzet e gjashtë) në ora 15:12.-----

Dhënësja e Autorizimit:-----

Kompania "INFINITT" SH.P.K.,-----

e përfaqësuar nga pronarja: Znj.Selvije Krasniqi:-----



NOTERE

Anduena I. Gashi Shehu



AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRIË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 644-26-3331-1-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: " INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË, Kosovë

E-mail: infinitt.shpk@gmail.com

Personi kontaktues: Astrit Uka

Telefoni: 044/974-590

Faxi: /

Numri fiskal: 601614177

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin 0%,8%apo18%,
Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH.
Çmimi duhet të shkruhet me dy decimale pas presjesë dhjetore, në të kundërtën nuk do të merret për bazë numri i tret pasë presjes

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Makine industriale per larje te kauqave dhe tepihave :Një fazor,Frekuenca 220-240;50/60,Fuqa 800 w,Airflow (l/s) 40,Ngritja e ujit (mmH2O: kPa) 2200;22,Kapaciteti i rezervuarit 22L,Kapaciteti i qeses 12L,Materiali i rezervuarit Çelik inox,Gjatësia e kabllit 7 m,Niveli i zhurmës (ISO 11201) (dB) 70,pesha 7.5kg,madhsia 40x45x58	copë	3.00	483.05	18.00	570.00	1,449.15	260.85	1,710.00
2	Frigorifer i kombinuar,Kapaciteti neto: 205 L,Kapaciteti i frigoriferit: 168 L,Kapaciteti i frizit: 37 L,Klasa energjisë: A,Ndriçimi i brendshëm: LED,Shpenzimet e energjisë: 283 kWh/vit,Përmasat: 143x54.5x55.5 cm,Niveli i zhurmës: 42 dB	copë	3.00	234.75	18.00	277.00	704.24	126.76	831.00
3	Frigorifer mini -Niveli i energjisë: E,Vëllimi Total: 82 l,Kapaciteti i ftohjes: 75 l,Niveli i zhurmës: 38 dB(A)re 1 pW,Dimensionet (GjxLxTh): 47,5 x 84,2 x 44,8 cm	copë	3.00	167.80	18.00	198.00	503.39	90.61	594.00
4	Shporet industrial Inox ,me 4 pllaka ,plakat te jenë 23x23 cm ,400v , 3 fazor, 10400 w, 50/60 hz lpx3, furra te jetë nga 0°C deri 450°C Termometri deri 500°C,dy butona kontrolli sipër dhe posht	copë	1.00	779.66	18.00	920.00	779.66	140.34	920.00

5	Friz- Fuqia: 120 W ;Niveli i energjisë: E, Vëllimi total: 191 l, Kapaciteti i ngrirjes në 24 orë: 10 kg, Niveli i zhurmës: 39 dB(A)re 1 pW, Dimensionet (GjxLxTh): 89,1 x 85,3 x 55,7	copë	3.00	184.75	18.00	218.00	554.24	99.76	654.00
6	Shporet elektrik : Fuqija 8200W , Niveli i energjisë A, Konsumimi i energjis 0.78 kwh, Dimensionet (GjxLxTh)60x85x60 cm	copë	3.00	167.80	18.00	198.00	503.39	90.61	594.00
7	Aparat për ftohje të ujit; Përdorimi për bidona 10l	copë	2.00	72.03	18.00	85.00	144.07	25.93	170.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM:							4,638.14	216.31	5,473.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	INFINITT SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Astrit Uka
NËNSHKRIMI:	
DATA:	18.05.2026.
VULA:	